



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 87, datë 07.05.2018

PËR

REFUZIMIN E ANKIMIT ADMINISTRATIV TË SHOQATËS SË SIGURUESVE TË SHQIPËRISË NDAJ VENDIMIT TË BORDIT TË AMF-SË NR. 72, DATË 04.04.2018

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe Kodit të Procedurës Administrative, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

KONSTATOI SE:

Bordi i AMF-së me anë të vendimit nr. 72, datë 04.04.2018 “Për disa shtesa e një ndryshim në rregulloren nr. 53, datë 25.06.2009 “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, e ndryshuar”, ka vendosur miratimin e disa shtesave dhe ndryshimit në këtë rregullore që lidhen me:

- Llogaritjen e dëmit moral dhe ekzistencial për dëmtime të tjera;
- Ndryshim në tabelën që përmban koeficientin e shumës së kapitalizuar.

Sipas vendimit të Bordit shtesat dhe ndryshimi i Rregullores nr. 53, datë 25.06.2009, do të zbatohen për ngjarjet e sigurimit nga data 1 korrik 2018 e në vazhdim.

Shoqata e Siguruesve me shkresat nr. 364 prot., datë 02.05.2018 dhe nr. 366 prot, datë 03.05.2018, ka depozituar në Autoritet ankim administrativ duke kërkuar anulimin e aktit administrativ, vendimin e Bordit nr. 72, datë 04.04.2018.

Autoriteti shqyrtoi shkaqet e parashtruara në ankim dhe konkludoi se:

I gjithë procesi i vendimmarrjes është kryer nga Autoriteti duke respektuar kërkesat procedurale ligjore të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative.

Pretendimet për nga ana materiale në lidhje me këtë vendim të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare nuk qëndrojnë për faktin se ndryshimet janë bërë në mbrojtje të interesave të konsumatorëve duke u konsultuar me palët e interesit.

Pas shqyrtimit rezulton se ankimi është i papranueshëm dhe i pabazuar.

Për sa më sipër Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Refuzimin e ankimit administrativ të Shoqatës së Siguruesve të Shqipërisë ndaj vendimit të Bordit të AMF-së nr. 72, datë 04.04.2018 “Për disa shtesa e një ndryshim në Rregulloren nr. 53, datë 25.06.2009 “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, e ndryshuar”.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI